Date __/ 03/ 2021

NJOFTIM

Drejtuar : Agjencise Kombetare te Mjedisit

Lenda: Kerkese per zhvillimin e procedures se degjeses me publikun

Shoqeria "NOVA Construction 2012" Sh.p.k njofton Agjencine Kombetare te Mjedisit per zhvillimin e procedures se informimit te publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit B per instalimin:

Grumbullim, ruajtje, magazinim, pastrim te mbetjeve jo te rrezikshme dhe lajre te kontenierеve me vendndodhje Zona Kadastrale 2726, Fshati Muçaj, Bashkia Vorë, Tiranë.

Ky njoftim hartohet Referuar VKM 419, date 25.06.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja" te ndryshuar, kreu VI "Informimi dhe pjesemarrja e publikut per aplikimin per leje mjedisi te tipit A dhe B", bashkangjitur gjeni dokumentacionin e kerkuar, sipas pikes 2 te ketij kreu:

a) Informacion nëse kërkesa do të jetë për "**Aplikim për leje mjedisi të tipit A ose të tipit B**" apo "Aplikim për ndryshim thelbësor në kushtet e lejes së mjedisit të tipit A ose të tipit B".
b) Të dhënat e ekstraktit të QKR-së;
c) Adresën e vendndodhjes së instalimit;
d) Përshkrimin e veprimtarisë që parashikohet të zhvillohet në instalim;
e) Një përshkrim të elementeve të listuara në formularin informues;
f) Përmbledhjen joteknike të raportit të vlerësimit të ndikimit në mjedis në nivel kombëtar ose ndërkufitar, kur kërkohet procedura e VNM-së;
g) Konsultimet ndërkufitare, kur kërkohet sipas legjislacionit në fuqi;
h) Autoritetin vendimmarrës për dhënien e aktit të miratimit të lejes së mjedisit, procedurat dhe afatet që do të ndiqen;
i) Adresën e AKM-së, ku publiku mund të dërgojë komentet dhe sugjerimet e tij, me shkrim apo në formë elektronike, brenda 20 (njëzet) ditëve nga data e njoftimit

a. Kerkesa per vendosjen ne funksionim te instalimit “Grumbullim, ruajtje, magazinim, pastrim te mbetjeve jo te rrezikshme dhe lajre te kontenierеve” eshte per aplikim **per leje te re mjedisore te tipi B**, sipas Shtojces 1, te Ligjit Nr. 52/2020, Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, date 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” të ndryshuar”,

Menaxhimi i mbetjeve

I.D 5.6 a Pastrim, larje, sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/paketimeve ose kontenierëve në mënyrë që të ripërdoren.

ID 5.6 b Magazinim i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive të pikës 5.6 a

ID 5.10 b Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart

“Trajtimi i ujërave dhe ujërave të zeza”

ID 6.4 Magazinim dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane duke përfshirë: - llumin nga ujërat e ndotura urbane - llumin e cisternave septike - mbetjet e ujërave të zeza nga gropa të hapura - Mbetjet nga pastrimi i kanaleve të ujërave të zeza.

b. TE DHENAT E EKSTRAKTIT TE QKB-SE

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

EKSTRAKT HISTORIK I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT “SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR”

GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L22404012D
2. Data e Regjistrimit	04/12/2012
3. Emri i Subjektit	NOVA Construction 2012
4. Forma ligjore	SHPK
5. Data e themelimit	03/12/2012
6. Kohëzgjatja	Nga: 03/12/2012
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr.10, Rruga Kajo Karafili, mbrapa ish lidhjes se shkrimtareve, pallati i shoqerise MC Inerte
8. Kapitali	100.000,00
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00
9. Objekti i aktivitetit	Ne fushen e projektimit dhe te ndertimit: kat. 1/e- planvendosje e objekteve te vecanta, kat. 2/a, projektime dhe ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore etj. Deri ne dy kate dhe kompletimin me instalimet e nevojshme per to, b- projektime dhe ndertime civile industriale, turistike, bujqesore etj. Dhe kompletimin e instalimeve te nevojshme per to; d- Projektim peizazhi (sistemime, lulishte, vepra arti, dekori, etj.) e- projektim interieri, mobile, paijisje, dizain

kopje nga web

c. ADRESA E VENDNDODHJES SE INSTALIMIT

<table>
<tr><td>Emri i instalimit/impiantit[1]</td><td>Grumbullim, ruajtje, magazinim, pastrim te mbetjeve jo te rrezikshme dhe lajre te kontenierеve</td></tr>
<tr><td>Adresa ku ndodhet apo do të ngrihet instalimi/impianti</td><td>Zona Kadastrale 2726, Fshati Muçaj, Bashkia Vorë, Tiranë</td></tr>
<tr><td>Koordinatat e vendit sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4
</td><td>
<table>
<tr><th colspan="3">Koordinatat e prones ku zhvillohet aktiviteti</th></tr>
<tr><th>Nr</th><th>X</th><th>Y</th></tr>
<tr><td>1</td><td>4584758.24</td><td>4388482.58</td></tr>
<tr><td>2</td><td>4584788.24</td><td>4388515.41</td></tr>
<tr><td>3</td><td>4584813.15</td><td>4388493.01</td></tr>
<tr><td>4</td><td>4584783.28</td><td>4388459.76</td></tr>
</table>
</td></tr>
<tr><td>Kategoritë e aktiviteteve/veprimtarive industriale të cilat duhet të kërkojnë leje mjedisi [2]</td><td>Menaxhimi i mbetjeve
I.D 5.6 a Pastrim, larje, sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/paketimeve ose kontenierëve në mënyrë që të ripërdoren.
ID 5.6 b Magazinim i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive të pikës 5.6 a
ID 5.10 b Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart
Trajtimi i ujërave dhe ujërave të zeza
ID 6.4 Magazinim dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane duke përfshirë: - llumin nga ujërat e ndotura urbane - llumin e cisternave septike - mbetjet e ujërave të zeza nga gropa të hapura - Mbetjet nga pastrimi i kanaleve të ujërave të zeza.</td></tr>
</table>

[1] Përshkruaj titullin sipas kollonës 1 të Shtojcës 1 të Ligjit Për lejet e mjedisit

[2] Shkruani kodet e specifikuara në kollonën 2 (e emërtuar ID) dhe aktivitetet e specifikuara në kollonën 3 (Veprimtaria) të përcaktuara në Shtojcën 1 të Ligjit për Lejet e Mjedisit. Nëse instalimi përfshin disa aktivitete të lidhura me IPPC, është e nevojshme për të shënuar secilin prej tyre me një kod. Kodet duhet të jenë të ndara qartë.

Kapaciteti i projektuar	• Stacion transferimi per mbetjet nga prishjet dhe ndertimet me kapacitet 60 ton/dite • Pastrim, larje te kontenieреve te mbetjeve urbane me kapacitet 60 ton/dite • Magazinimi i perkohshem i mbetjeve nga prishjet/ndertimet me kapacitet 60 ton/dite • Magazinimi llumrave te ujerave te ndotura me kapacitet 65m^3/dite

d. PERSHKRIMI I VEPRIMTARISE QE PARASHIKOHET TE ZHVILLOHET

AKTIVITETI: Grumbullim, ruajtje, magazinim, pastrim te mbetjeve jo te rrezikshme dhe lajre te kontenieреve

Adresa: Zona Kadastrale 2726, Fshati Muçaj, Bashkia Vorë, Tiranë

Subjekti: "**NOVA Construction 2012**" Sh.p.k

Administrator: Z. Enea Kaçi

- **Hyrje**

Profili i shoqërisë "NOVA Construction 2012l" Sh.p.k

Instalimet per grumbullim, ruajtje, magazinimin, pastrim te mbetjeve jo te rrezikshme dhe larje te kontenieреve ne menyre qe te riperdoren të shoqërisë **"NOVA Construction 2012" shpk** është i

pozicionuar ne Zona Kadastrale 2726, Fshati Muçaj, Bashkia Vorë, Tiranë. Kjo shoqëri është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, për aktivitetin ne fushen e projektimit dhe te ndertimit, rikonstruksione godinash civile dhe ekonomike, transport te udhetareve dhe mallarave**..... etj**. **Grumbullim, transportim, ruajtje, magazinimin, pastrim te kontenierеve te mbetjeve jo te rrezikshme. Vleresimi i Ndikimit ne Mjedis dhe Auditim Mjedisor,** me NR NIPT: **L22404012D**.

Prona ku zhvillohet veprimtaria ne fushen e menaxhimit te integruar te mbetjeve jo te rrezikshme, eshte marre me qira nga shoqeria. Sheshi eshte i shtruar me beton, ku ushtrohen veprimtarite per larjen/pastrimin e kontenierеve, magazinimin e mbetjeve te kontenierеve, magazinimin e llumrave te ujerave te ndotura dhe stacion transferimi te mbetjeve dhe mbetjeve nga prishjet/ndertimet. Brenda siperfaqes se menaxhimit te mbetjeve eshte ndertuar infrastruktura rrugore e cila komunikon me akset rrugore kryesore te Bashkise Vore. Prona disponon hapesirat e nevojshme per zhvillimin e proceseve, levizjen e mjeteve te transportit dhe mjeteve teknologjike qe kryejne operacionet ne fushen e menaxhimit te integruar te mbetjeve. Pergjate gjithe gjatesise se siperfaqes ku zhvillohen proceset e menaxhimit te mbetjeve eshte ndertuar rrjeti i drenazhimit te ujerave siperfaqesore dhe ujerave te larjes/pastrimit te kontenierеve, te cilet dergohen ne vasken e dekantimit te ujerave dhe me pas magazinohen lidhen me rrjetin e kanalizimeve te zones.



Informacion mbi kompanine "NOVA Construction 2012" sh.p.k

Shoqeria **"NOVA Construction 2012" sh.p.k** eshte nje subjekt i regjistruar dhe zhvillon aktivitetin e saj ekonomik ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, ku objekt te veprimtarise se saj ne fushen e punimeve civile, infrastrukturore, menaxhimin e mbetje, etj. Duke pare te gjithe fushen e veprimtarise ku operon, shoqeria kerkon te kryej menaxhimin e integruar te mbetjeve ne fushen e "Grumbullim, ruajtje, magazinim, pastrim te mbetjeve jo te rrezikshme dhe lajre te kontenierеve". Qellimi i firmes ka qene dhe mbetet permbushja e kerkesave te cilesise dhe per kete kompania ndjek dhe zbaton me rigorozitet menaxhimin e cilesise ne te gjitha hallkat e saj.

Per kete qellim, subjekti **"NOVA Construction 2012" sh.p.k** referuar Shtojces 1 te Ligjit nr. 52/2020 Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 448, date 14.7.2011 "Për lejet e mjedisit" të ndryshuar dhe VKM nr. 419, datë 25.6.2014 "Për miratimin e kërkesave të posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A, B dhe C, për transferimin e lejeve nga një subjekt te tjetri, të kushteve për lejet respektive të mjedisit, si dhe rregullave të hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja" te ndryshuar, Kreu VI ka plotesuar dokumentacionin e kerkuar per tu pajisur me Leje Mjedisi te Tipit B per aktivitetin Grumbullim, ruajtje, magazinim, pastrim te mbetjeve jo te rrezikshme dhe lajre te kontenierеve, me vendndodhje Zona Kadastrale 2726, Fshati Muçaj, Bashkia Vorë, Tiranë. Subjekti ka siguruar staf dhe pajisje, makineri profesionale per zhvillimin e ketij aktiviteti.

Vendosja e ketij instalimi ne kete zone eshte e pershtatshme per zhvillimin e ketij aktiviteti pasi eshte ne distance te konsiderueshme nga zonat e banuara, objektet apo veprat hidroenergjetike, etj, ne zonen ne studim eshte perqendruar nje numer i madh i bizneseve me karakter industrial.

Qëllimi i këtij aktiviteti është menaxhimi i integruar i mbetjeve qe gjenerohen nga sektori i prodhimeve infrastrukturore dhe sektoret industriale te ndryshem qe gjenerojne mbetje jo te rrezikshme, duke bere te mundur ruajtjen, magazinimin e perkohshem dhe transferimin e tyre drejt operatoreve te licencuar per trajtimin apo asgjesimin perfundimtar te tyre

Aktiviteti zhvillohet ne nje ambjent te pershtatshem per kete aktivitet duke mos krijuar keshtu deme apo efekte negative te ndryshme ne mjedisin perreth.

- **Instalimet per menaxhimin e integruar te mbetjeve jane:**
  1- Stacion transferimi per mbetjet nga prishjet/ndertimet
  2- Ruajtje/Magazinim i kontenieреve te mbetjeve nga prishjet/ndertimet qe gjenerohen nga proceset e pastrimit/larjes se kontenieреve
  3- Pastrim, larje te kontenieреve te mbetjeve te ngurta
  4- Magazinimi i mbetjeve te llumrave dhe ujerave te ndotura urbane

Operatori NOVA Construction 2012 Sh.p.k kryesisht operon ne fushen e punimeve infrastrukturore, lind nevoja e ofrimit te sherbimit te menaxhimit te mbetjeve qe gjenerohen nga procese te tilla te punes dhe ofrimin e sherbimit te pastrimit te siperfaqeve urbane, mbetjeve te paketimeve, mbetjeve nga prishjet/ndetimet dhe mbetjeve te ujerave te ndotura urbane, ndaj shoqerive me te cilat ky operator ka nenshkruar kontratat perkatese te sherbimit, si dhe ofrimin e sherbimit te pastrimit te punimeve kontraktuale dhe nenkontraktuale per te cilat kjo shoqeri operon ne fushen e prodhimeve infrastrukturore. Si nje shoqeri sensitive me ceshtjet mjedisore aktuale dhe me ceshtjet e menaxhimit te integruar te mbetjeve, operatori NOVA Construction 2012 Sh.p.k ka marre te gjitha masat perkatese per marrjen e lejeve dhe licencave perkatese me qellim mbrotjen e mjedisit, shendetit te punonjesve, parandalimin e minimizimin e mbetjeve ose pakesimin e ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve dhe permiresimin e eficences se perdorimit te tyre.

Mbetjet jo te rrezikshme do te transportohen me ane te mjeteve teknologjike, sipas tipologjise dhe kodeve te mbetjeve, te cilat mund te behen me transferte direkte drejt operatoreve te licencuar per trajtimin/asgjesimin perfundimtar te tyre, ose me ndalese ne stacionin e transferimit te mbetjeve per ruajtjen/magazinimin e perkohshem te tyre deri ne plotesimin e sasise se kerkuar per transferim drejt operatoreve te licencuar per trajtimin/asgjesimin perfundimtar te mbetjeve.

Gjithashtu ne objektin ku ushtrohet veprimtaria kryhen operacionet e larjes dhe mirembajtjes se kontenieреve te mbetjeve te cilat mundesojne qe te kryhet manaxhimi i integruar i mbetjeve, duke i riderguar perseri ne objektet ne te cilat jane nenshkruar kontratat e sherbimit per menaxhimin e mbetjeve jo te rrezikshme.

Nje tjeter proces qe kryhet ne objektin e menaxhimit te mbetjeve, eshte ai i parkimit te mjeteve te transportit te cilat mundesojne transportin e mbetjeve nga gjeneruesi i mbetjeve drejt objektit te transferimit apo transportin e tyre nga gjeneruesi i mbetjeve drejt operatoreve te licencuar per trajtimin/asgjesimin perfundimtar te mbetjeve.

Me hapsirat e krijuara në këtë aktivitet mundesohet nje levizje e mire e mjeteve te transportit te mbetjeve si dhe mjeteve te tjera te cilat i sherbejne aktiviteti.

Të gjitha mbetjet të cilat do të ruhen/magazinohen përkohësisht në stacionin e transferimit të mbetjeve, do të asgjësohen nga operator të licencuar brenda territorit të shqipërisë në varësi të kodeve, tipologjisë dhe teknologjisë së kërkuar për të tilla mbetje, pra nuk do të kemi depozitim përfundimtar të tyre ne territorin e kerkuar per leje mjedisi.

Ambienti eshte i shtruar me beton dhe i pajisur me rrjetin e drenazhimit te ujrave te shiut, duke shmangur mundesine e ndotjes se mjedisit nga levizja e mjeteve, si dhe reduktimin e shkarkimeve ne ajer nga te grimcave te pluhurit si rezultat i levizjes se mjeteve te transportit. Pozicionimi kadastral i zones si dhe infrastruktura e brendshme e objektit eshte e lidhur me infrastrukturen e zones, me rrugen dytesore Tirane-Vore, duke mundesuar nje korsi ngadalesimi ne hyrje dhe nje korsi shpejtesie ne dalje nga rruga e cila te dergon per tek objekti, cka ben te mundur qe ky objekt te mos ndikoje ne trafikun e zones. Gjithashtu pergjate gjithe gjatesise se infrastruktures se brendshme eshte ndertuar edhe rrjeti i drenazhimeve te ujrave te shiut.

Infrastruktura prane eshte e mire, me standartet bazike te saj. Gjithashtu objekti nuk perben problem per trafikun perqark zones ne te cilin ndodhet. Aksi i rruges kryesore nga prane tij eshte i shtruar me asfalt si dhe eshte i gjelberuar ne menyre natyrale. Ky shesh per nga madhesia e aktivitetit lejon qarkullimin e lire, hyrje – dalje si dhe manovrimet e automjeteve (mjeteve teknologjike te transporti, kamionave dhe mjeteve te tjera te pastrimit) te cilat do ti sherbejne ketij aktiviteti ne kushte te plota sigurie, si dhe mjetet e zjarrfikesve ne rastet emergjente te cilat mund te shfaqen ne kete kete aktivitet.

Me qellim ushtrimin e veprimtarise per menaxhimin e mbetjeve, referuar ligjit nr. 10 463, date 22.09.2011 “Per menaxhimin e integruar te mbetjeve” i ndryshuar subjekti ka marre masat e nevojshme per ndertimin e te gjithe infrastruktres inxhinierike me qellim mbrotjen e mjedisit dhe siperfaqes se prones ku do te zhvillohet aktiviteti.

Qellimi i shoqerise eshte:

a) parandalimit e minimizimit të mbetjeve ose pakësimit të ndikimeve negative nga krijimi dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve;

b) përmirësimit të efiçencës së përdorimit të tyre;

c) pakësimit të ndikimeve negative të përgjithshme nga përdorimi i burimeve.

- **Ndërtimi i linjës elektrike**

Në varësi të llojit të pajisjeve dhe fuqisë së instaluar është zgjedhur edhe fuqia e transformatorit të kabinës elektrike. Aktualisht rrejti i shpërndarjes së energjisë elektrike eshtë në gjëndje mjaft të mire dhe kuadri elektrik është i plotësuar. Siperfaqja ku ushtrohet veprimtaria per menaxhimin e mbetjeve në të gjitha ambjentet e tyre jane pajisur me kaseta të shpërndarjes së energjisë elektrike. Per mbrojtjen nga shkarkimet atmosferike eshte parashikuar nje rrjet tokezimi ne zonen e rezervuareve dhe sisteme tokezimi te vecanta per cdo pajisje.

- **Rruga hyrëse për në objekt dhe rrugët e brëndshme**

Objekti lidhet me rrugen dytesore Tirane-Vore, duke mundesuar nje korsi ngadalesimi ne hyrje dhe nje korsi shpejtesie ne dalje nga rruga e cila te dergon per tek objekti, cka ben te mundur qe ky

objekt te mos ndikoje ne trafikun e zones. Gjithashtu pergjate gjithe gjatesise se infrastruktures se brendshme eshte ndertuar edhe rrjeti i drenazhimeve te ujrave te shiut.

Infrastruktura prane eshte e mire, me standartet bazike te saj. Gjithashtu objekti nuk perben problem per trafikun perqark zones ne te cilin ndodhet. Aksi i rruges kryesore nga prane tij eshte i shtruar me asfalt si dhe eshte i gjelberuar ne menyre natyrale.



Zona ne studim, ka dendesi te ulet te banesave te karakterit banim dhe sherbimi te cilat jane ndertuar ne menyre informale pas viteve 90-te si pasoje e levizjeve demografike te popullsise, ku aktualit gjendet nje numer i ulet i banoreve.

Prona ku kerkohet te zhvillohet aktiviteti ben pjese ne njesine strukturore VO_UB_S_1-17 me destinacion Sherbime, sipas Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Vore.



Planvendosja e impiantit e paraqitur në ortofoto.

Planvendosja e impiantit sipas Gaus Kruger 1942 Zone 4



e. PERMBLEDHJA NE GJUHE JO-TEKNIKE

Përmbledhja duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- **INSTALIMI DHE AKTIVITETET E TIJ;**
- **Menaxhimi i mbetjeve**

I.D 5.6 a Pastrim, larje, sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/paketimeve ose kontenierëve në mënyrë që të ripërdoren.

ID 5.6 b Magazinim i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive të pikës 5.6 a

ID 5.10 b Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart

- **Trajtimi i ujërave dhe ujërave të zeza**

ID 6.4 Magazinim dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane duke përfshirë: - llumin nga ujërat e ndotura urbane - llumin e cisternave septike - mbetjet e ujërave të zeza nga gropa të hapura - Mbetjet nga pastrimi i kanaleve të ujërave të zeza

- **LËNDËT E PARA DHE ATO NDIHMËSE, SUBSTANCAT E TJERA DHE ENERGJIA E PËRDORUR OSE E GJENERUAR NGA INSTALIMI;**

Lendet e para per vendosjen ne funksionim te instalimeve jane karburanti, kontenieret, mjetet e transportit, ndersa lendet ndihmese jane energjia dhe uji.
Gjithashtu si lende e pare (mbetje) te cilat menaxhohen nga shoqeria NOVA Construction 2012 te cilat dergohen ne objektin e ushtrimit te veprimtarise, te cilat referuar VKM-se Nr. 99, datë 18.02.2005 “Për miratimin e katalogut Shqiptar të Klasifikimit të Mbetjeve”,

- **BURIMET E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI;**

Shkarkimet kryesore në ajër – Karakteristikat e shkarkimeve (një faqe për çdo pikë shkarkimi)

Nr. Referencës së pikës së shkarkimit	Sh1
Burimi i shkarkimit	Ruajtje/magazinimi, transferimit te mbetjeve
Përshkrimi	Proceset e ruajtjes/magazinimit, transferimit te mbetjeve
Koordinatat: (GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4)	Pika 1 X: 4584794.47 Y: 4388484.19
Informacion mbi oxhakun Diametri Lartësia nga toka(m)	
Data e fillimit të shkarkimeve	

Shkarkimet në rrjetin e kanalizimeve (një faqe për çdo pikë të shkarkimeve)

Nr. Ref. i pikës së shkarkimit: (numri i referencës duhet të jetë i njëjtë me numrin e shkruar në hartën e instalimit)	K1

Vendndodhja e pikës së shkarkimit rrjetin e kanalizimeve	Ne brendesi te territorit ku zhvillohet aktiviteti. Ujerat e pastrimit, larjes se kontenieреve
Koordinatat (për efekt të vlerësimit të ndikimit)	X : 4584782.03 Y : 4388507.15
Emri i kompanisë e cila menaxhon sistemin e grumbullimit të ujërave të ndotura	**NOVA Construction 2012**
A është sistemi i kanalizimeve i lidhur me një impiant trajtimi?	Vaske dekantimit
Emri i mjedisit përfundimtar ujor pritës të ujërave të ndotura nga rrjeti i kanalizimit (estuar, lumë ose mjedis tjetër ujor pritës dhe ndikimi në të i cili duhet kontrolluar)	Grumbullohen dhe orientohen per tek puseta e perbashket e rrjetit te kanalizimeve te zones

Shkarkimet e zhurmës – Përmbledhje e listës së burimeve të shkarkimit të zhurmës

Burimi i shkarkimit	**Nr. Ref. i pikës së shkarkimit**	**Koordinatat sipas sistemit GAUS KRUGE: 1942_GK_ZONE_4**	**Nr. Ref. i pajisjes që gjeneron ndotje aklustike**	**Presioni akustik[1] (dBA) duke ju referuar distancës**	**Periudha e shkarkimit**
Stacioni i transferimit te mbetjeve nga prishjet/ndertimet	1	X: 4584794.47 Y: 4388484.19		55	Gjate proceseve te funksionimit
Proceset e pastrimit/larjes se kontenieреve dhe Magazinimi i kontenieреve	2	X: 4584780.99 Y: 4388499.44		60	Gjate proceseve te funksionimit

- **KUSHTET NË VENDNDODHJEN E INSTALIMIT DHE RASTET E NJOHURA HISTORIKE TË NDOTJES;**

Zona ku do te zhvillohet aktiviteti per menaxhimin e mbetjeve, ruajtje, magazinim, pastrim-larje te kontenieреve ndodhet ne Zona Kadastrale 2726, Fshati Muçaj, Bashkia Vorë, Tiranë.

Ne kete zone jane te perqendruar nje numer i konsiderueshem i subjekteve qe operojne ne fushen e menaxhimit te mbetjeve, prodhimit te materialeve te ndertimit, tregetimit te karburanteve, prodhimin e mobiljeve, prodhimin e makinerive te ndryshme, tregetimit te materivaleve te ndertimit, etj, duke qene se destinacioni i zones eshte terisisht sherbime.

- **IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE NE MJEDIS DHE MASAT PER MINIMIZIMIN E TYRE**

Mjedisi eshte gjithmone i prekur nga veprimtarite e ndryshme qe ushtrohen ne te, por ndikimi mund te jete i ndryshem, kjo eshte e lidhur ngushte me vete llojin e veprimtarise e cila mund te kete impakt te drejtperdrejte, te terthorte, te rendesishem apo mesatar i pranueshem.

Nje nga objektivat e ketij raporti eshte identifikimi i ndikimeve te mundshme qe mund te shkaktohen ne mjedis nga ky aktivitet ne teresi. Identifikimi i ndikimeve te mundshme ne mjedisin e kesaj zone do te vleresohen ne njeren prej fazave kryesore; faza e operimit, pasi objekti eshte i ndertuar dhe ndikimi ne mjedis do te jete vetem nga funksionimi i paisjeve, mjeteve dhe makinerive te transferimit, magazinimit kontenierеve dhe larjes/pastrimit te kontenierеve dhe magazinimit te perkohshem te mbetjeve. Nuk marrin ne konsiderate fazen pas perfundimit se veprimtarise pasi ky projekt do te vazhdoj te jete i tille dhe pas shume kohesh. Disa prej ndikimeve kryesore qe jane vleresuar si te mundshme jane paraqitur si me poshte.

Efektet e mundshme nga aktiviteti qe ushtrohet do te vleresohen ne menyre te pergjithshme nga ky raport i ndikimeve në mjedis. Megjithate, shume nga efektet e mundshme mund te identifikohen per arsye te eksperiences nga nen-projektet e projektet e meparshme ne kete fushe.

- **Impakti ne mjedis i ketij impianti dhe menaxhimi i tij**

Ne vijim do te paraqesim nje permbledhje te efekteve negative mbi mjedisin te cilat lidhen me operimin e punes ne instalimet e transferimit, magazinimit kontenierеve, larjes/pastrimit te kontenierеve dhe magazinimit te perkohshem te mbetjeve te perdorur gjate fazes operative sebashku me rekomandimet mbi menaxhimin e tyre.

Ceshtjet e mjedisit te lidhura me fazat e transferimit, magazinimit kontenierеve, larjes/pastrimit te kontenierеve dhe magazinimit te perkohshem te mbetjeve ne llogjiken e ciklit te jetes se produktit perfshijne:

- Praktikat e qendrueshme: Impakti me i madh mjedisor si ruajte/magazinim i mbetjeve konsiston ne menaxhimin e lendes se pare duke maksimizuar perdorimin e lendeve te para.
- Praktika te qendrueshme ne menaxhimin e lendes se pare gjate transferimit, ruajtjes, magazinimit dhe perdorimin sa me eficent te saj, duke riperdorur dhe ricikluar ate sasi te mbetjeve qe gjenerohet si mbetje gjate ketij procesi.
- Praktika te qendrueshme ne reduktimin e emetimeve ne ajer nga procesi ruajtjes/magazinimit te mbetjeve,

Aspektet mjedisore me te rendesishme qe lidhen me instalimet e transferimit, magazinimit kontenierеve, larjes/pastrimit te kontenierеve dhe magazinimit te mbetjeve kane te bejne kryesisht me shkarkimet ne ajer, shkarkimet ne ujerave dhe prodhimin e mbetjeve te ngurta.

- **Shkarkimet ne ajer**

Nga proceset e transferimit, magazinimit kontenierеve, larjes/pastrimit te kontenierеve dhe magazinimit te mbetjeve, kemi gjenerimit te gazrave nga levizja e mjeteve te transportit dhe pluhura nga proceset e transferimit te mbetjeve..

- **Shkarkime ne ujera**

Nje ndikim tjeter i pranishem ne objektin ku zhvillohet aktiviteti eshte dhe menaxhimi i ujrave, Ujrat e gjeneruara nga proceset e pastrimit, larjes se kontenierеve, grumbullohen ne rrjetin e brendshme

te kanalizimeve dhe perfundojne ne puseten e dekantimit te ujerave, nga ku orientohen per ne kolektorin e perbashket te zones te ujerave te ndotura urbane.

- **Mbetjet e ngurta urbane**

Mbetjet qe gjenerohen nga procesi i pastrimi/larja e kontenierеve dhe nga aktiviteti i perditshme i aktiviteti te punonjesve diferencohen ne konteniere me volum 13.5 m^3, nga ku pasi eshte plotesuar sasia e kerkuar transferohen drejte operatoreve te licencuar per trajtimin/asgjesimin perfundimtar te tyre.

- **Gjenerinimi i zhurmave**

Zhurmat e gjeneruara ne objektin ku ushtrohet veprimtaria vijne si rezultat i levizjes se mjeteve te transportit dhe proceseve te shkarkimit - ngarkimit te mjeteve te transportit per menaxhimin e integruar te mbetjeve te ngurta.

- **Ndikimet sociale**

Nga zhvillimi i veprimtarise per menaxhimin e integruar te mbetjeve nuk kemi ndikime negative sociale, perkundrazi ushtrimi i veprimtarise do te kerkoje punesimin e personave te zones, per te cilet do te investohet nga shoqeria per trajnimin dhe kualifikimin e tyre ne fushen e menaxhimit te integruar te mbetjeve.

- **TEKNOLOGJIA DHE TEKNIKA TË TJERA TË PROPOZUARA PËR PARANDALIMIN E SHKARKIMEVE OSE, KUR KJO NUK ËSHTË E MUNDUR, PËR PAKËSIMIN E SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI, VEÇANËRISHT DUKE ZBATUAR TEKNIKAT MË TË MIRA TË DISPONUESHME;**

Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim negativ

Rekomandime për zbutjen e ndikimeve	
Toka	
Përdorimi i Tokës	Kryerja e aktivitetit brënda koordinatave dhënë në relacion. Rrespektimi i kushteve teknike dhe standarteve.
Erozioni	
Mbrojtja nga erozioni	Zbatimi rigoroz i masave teknike për operimin e transferimit, magazinimit kontenierеve, larjes/pastrimit te kontenierеve dhe magazinimit te mbetjeve. Pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave të shiut. Mbjellja e fidanëve përreth perimetrit të objektit në përdorim, me qëllim mbrojtjen e kompaktësisë së tokës. Mirembajtja e bazamentit ku jane te istaluara pajisjet dhe makinerite
Biodiversiteti	
Vegjetacioni **Dëmtim potencial i vegjetacionit**	Mirëmbajtja e kurorës së pemëve dhe bimësisë së mjedisit në përdorim nga shoqëria. Mbjellja e fidaneve te rinj, pergjate rruges qe ben te mundur hyrjen per ne objekt.
Cilësia e ajrit	
Rritje e emetimeve ne ajer	Mirembajtja e linjes dhe reduktimi i shkarkimeve ne ajer.

nga funksionimi i linjes se pastrimit/larjes, magazinimit dhe transferimit te mbetjeve	Mjete me kolaudim optimal. Pjesë kembimi rezerve brënda objektit për raste emergjente. Plan veprimi në rast rrjedhjesh. Përdorimi efiçent i mjeteve motorrike. Përdorim i karburanti cilësor. Pastrim periodik i objektit të zonës në shfrytëzim dhe mjeteve të punës. Pastrimi periodik i linjës së transferimit, magazinimit kontenierеve, larjes/pastrimit te kontenierеve dhe magazinimit te mbetjeve duke mbarëvajtur operimin optimal të tij.
Sistemi i drenazhimit	
Sistemi i drenazhimit	Mirembajtja e sistemit të drenazhimit të ujrave të shiut dhe ujrave te pastrimit/larjes përgjatë gjithë gjatësisë së objektit, bashkimi i tyre në një pusete dekantimi të përbashkët dhe me pas dergimi i tyre ne kolektorin e perbashket te zones te ujerave te ndotura urbane.
Mbetjet	
Shtim i mbetjeve industriale dhe urbane nga aktiviteti human i punonjësve që do të operojnë në objekt.	Vendosja e kontenierëve në brendësi dhe jashtë objektit, diferencimi i mbetjeve sipas fraksioneve të gjeneruara dhe transportimi periodik i tyre drejt operatoreve te licencuar. Rikuperim, Riciklim dhe Ripërdorim ne maksimum i mbetjeve te gjeneruar nga instalimet. Rritja e eficiences se perdorimit te mbetjeve
Zhurmat	
Rritje e nivelit të zhurmave nga impianti dhe nga lëvizja e automjeteve	Përdorimi i mjeteve të kolauduara. Ushtimi i operacioneve te transferimit, magazinimit kontenierеve, larjes/pastrimit te kontenierеve dhe magazinimit te mbetjeve brenda orareve të caktuara, nga rregullorja e punës. Përdorimi i mjeteve mbrojtëse nga punonjësit (kufje për mbrojtjen e aparatit të dëgjimit). Përdorimi i mjeteve të punës dhe të transportit gjat orareve të përshtatshme.
Trafiku rrugor	
Trafiku Rrugor **Rritje e fluksit të qarkullimit të automjeteve**	Lëvizshmeria do të studiohet të kryhet në oraret ku shmanget piku i trafikut. Mjetet e transportit do te levizin brenda normave te lejuara te shpejtesise, referuar Kodit Shqiptar Rrugor.

- **ALTERNATIVËN NË LIDHJE ME ZGJEDHJEN E VENDIT TË INSTALIMIT DHE TEKNOLOGJINË E PËRDORUR;**

Shoqeria NOVA Construction 2012 Sh.p.k ka marre me qira siperfaqen e prones ku do te zhvillohet veprimtaria e cila është i pozicionuar ne Zona Kadastrale 2726, Fshati Muçaj, Bashkia Vorë, Tiranë.

Prona ku do te zhvillohet veprimtaria per menaxhimin e mbetjeve eshte ekzistuese dhe ben pjese ne njesine strukturore VO_UB_S_1-17 me destinacion Sherbime, sipas Planit te Pergjithshem Vendor te Bashkise Vore.



- **MASAT PËR PARANDALIMIN DHE RIKUPERIMIN E MBETJEVE (NËSE ËSHTË E NEVOJSHME);**

Instalimet per te cilat kerkohet pajisja me leje mjedisi konsistojne ne menaxhimin e integruar te mbetjeve per te cilat eshte sqaruar me lart proceset qe zhvillohen per secilin nga instalimet. Me poshte po paraqesim ne vija te pergjithshme:

Objektivat e projektit te menaxhimit te mbetjeve jane:

- Ndertimi i nje rrjeti te menaxhimit te integruar te mbetjeve brenda siperfaqes ku ushtrohet veprimtaria dhe ne objektet/territoret ku operon shoqeria. Ky rrjet konsiston ne
  1- Grumbullimin/Magazinimit;
  2- Pastrim/larje te kontenierеve
  3-Riperdorimin i kontenierеve
- Rritja e eficiences se perdorimit te mbetjeve
- Reduktimi i siperfaqes se ruajtjes/magazinimit te mbetjeve, duke parandaluar, kontrolluar dhe ulur ndotjen e tokes, ajrit dhe ujit.
- Reduktimi, pakesimi dhe parandalimi i ndotjes se tokes per menaxhimin e mbetjeve te ngurta dhe sigurimin, permiresimin e cilesise se jetes dhe shendetit te njeriut.

- **MASA TË TJERA TË PLANIFIKUARA NË PËRPUTHJE ME PARIMET E PËRGJITHSHME QË RREGULLOJNË DETYRIMET THEMELORE TË OPERATORIT, DMTH:**

Për plotësimin e kërkesave të klientëve, rritjen e cilësisë së shërbimit të ofruar, rritjen e masave të sigurisë gjatë procesit të operimit ne objektin ku ushtrohet veprimtaria e pastrim, larje te kontenierеve te mbetjeve, stacionin e transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme dhe magazinimin e perkohshem te mbetjeve, mbrojtjen nga pluhurat, gazrat, zhurmat, etj, mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe komunitetit të zonës përreth, me qëllim kryesor “Mbrojtjen e Mjedisit”, reduktimin e sasisë së emetuar të PM10, PM2.5, CO_2, NOx, SOx në atmosfere, përdorimin e energjisë në mënyrë efiçente, duke menduar për gjeneratat e brezave pasardhës, subjekti **“NOVA Construction**

2012" Sh.p.k, me përfaqësues ligjor Z. Enea Kaçi ka hartuar "Programin e Përmirësimit të Operimit të Proceseve Teknike të Punës", sipas termave të mëposhtme.

Programi i përmirësimit të operimit mbështetet në këto parime të zbatueshme

Çfarë	*Masat*	*Kush i zbaton*
Parandalim	- Përzgjedhja dhe trajnimi i personelit për mënyrën e veprimit gjatë magazinimit, transportimit dhe përdorimit të teknologjisë. - Zbatim rigoroz i sigurimit teknik gjatë punës dhe ndërprerjes së saj në rast avarie të mundshme. - Montimi i të gjithë aparateve sinjalizuese të sigurisë dhe rrjetit elektrik. - Tokëzimi dhe rrufe pritëse, në të gjith instalimet për të shmangur aksidente me pasoja në mjedis. - Pajisjet dhe aparaturat do të mbahen gjithmonë të fikura, kur nuk ka procese të operimit nga aktiviteti i Pastrimit, larjes dhe sprucimit te kontenierеve dhe stacionit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme. - Mbajtja e pajisjeve të nevoshjme, nga punonjësit për operimin e punës, si: doreza, këpucë me veshje gome, syze për mbrojtjen e syve, maska kundra gazeve dhe pluhurave, gjatë gjithë kohës dhe proceseve që zhvillohen - Kapja dhe pastrimi i menjëhershëm në rast derdhjesh të lubrifikantëve dhe bojrave, si dhe grumbullimi i tyre në kontenier (fuçia) të mbyllura hermetikisht me qëllim asgjesimin e tyre përfundimtar nga kompanit e nënkontraktuar. - Menaxhimi i integruar i mbetjeve. - Testimi paraprak i gjithë teknologjisë (instalimeve dhe automjeteve te pastrimit) dhe rrjetit elektrik. - Pastrimi periodik i vendit të pastrimit te kontenierеve dhe sheshin e parkimit te automjeteve/makinerive te transportit, pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike te larjes dhe të shiut. - Kolaudimi periodik i automjeteve. - Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e shoqërisë.	Investitori, Drejtuesi Teknik dhe punonjësit.
Kontroll	- Kontroll i automatizuar i të gjithë automjeteve, nëpërmjet programeve inxhinierike - Pastrimi i sheshit ku zhvillohet aktiviteti dhe pajisjeve te punes. - Pastrimi i rrjetit të drenazhimit të ujrave teknologjike dhe ujrave të shiut përgjatë perimetrit nën administrimin e subjektit ku zhvillohet aktiviteti. - Vëzhgimi dhe kulaudimi i vazhdueshëm i të gjithë instalimeve dhe automjeteve/makinerive te pastrimit te mbetjve. - Përdorimi eficenti i energjisë elektrike si dhe sigurimi i ambientit të objektit me ndriçimin e duhur për zhvillimin e aktivitetit.	Drejtuesi Teknik dhe punonjësit.

	- Menaxhimi i integruar i mbetjve ne zbatim te kushteve te kontrate se pastrimit - Monitorimi periodik i parametrave mjedisor dhe regjistrimi i të dhënave në regjistrin e subjektit. - Sigurimi i të gjithë pajisjeve të nevojshme për riparimin, pastrimin dhe ndërhyrje në rast emergjencash. - Trajnimi periodik i punonjësve dhe njohja me planin e ndihmës së shpejtë dhe planin e përballimit të emergjencave të ndryshme.	
Ndërhyrje	- Riparimi i menjehershëm i difekteve dhe avarive teknologjike - Mobilizimi i menjëhershëm i stafit dhe mjeteve të fikjes së zjarrit. - Kolaudimi dhe shërbimi i pajisjeve/aparatura nga ekspertë të licensuar, çdo fillim viti. - Zëvendësimi i menjëhershëm të pjesëve të pajisjeve/ aparaturave dhe mjeteve të punës, në rastet e avarive të mundshme. - Rigjenerimi i ambientit të dëmtuar. - Riparimi i menjëhershëm i teknologjisë dhe automjeteve, në raste avarie të mundshme apo dëmtim të instalimeve. - Në rastet e avarive të ndryshme do të njoftohet i gjithë stafi i punonjësve dhe klientët e gjendur aty, me qëllim sigurimin e jetës së tyre dhe ndërhyrjen për sigurimin e automjeteve dhe pajisjeve kryesore. - Reduktimi i sasisë së ujrave të përdorura për qëllime sanitare, si dhe në rastet e kontaminimit me mbetje të rrezikshme izolimi i tyre në kontenier të posaçëm dhe të izoluar hermetikisht. - Pajisja e zones së shfrytëzuar me sinjalistikën e duhur dhe shenjat dalluese në rastet e rrezikut të mundshëm, për operimin normal të punës në objekt. - Njoftimi i menjehershëm i automjeteve dhe njësive të specializuara në rast emergjencash (zjarrfikëse, autoambulanca, etj).	Personeli dhe organet Shtetërore të Specializuara.
Administrim	- Përdorimi dhe ruajtja me përgjegjësi i të gjithë, zones, instalimeve, infrastrukturës dhe mjeteve të përshkuara më sipër.	

Raportimi i masa të ndërmarra për programin e përmirësimit të operimit

Raportimi i masave që do të ndërmerren në objektin ku ndodhet impianti per larjen, pastrimin e kontenierеve, Stacion transferimi te mbetjeve jo te rrezikshme dhe magazinimin e perkohshem te mbetjeve, do të kryhet nga subjekti **"NOVA Construction 2012" Sh.p.k** sipas një kalendari dhe regjistri të veçantë, i cili do të plotësohet nga drejtuesi teknik i punës në impiant dhe do të raportohet pranë Agjencisë Kombetare të Mjedisit, me miratimin e Përfaqësuesit Ligjor, Z. Enea Kaçi.

- **Masa lehtësuese të tjera të kërkuara/ndërmarra**

➢ Të vendosen kontenier për mbajtjen pastër të ambjenteve nga mbetjet urbane për numrin e punonjësve.

- Investitori të respektojë detyrimet qe do te vendosen në Lejen Mjedisore tipi B që do të miratohet nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit.
- Subjekti të respektojë të gjitha masat/normat/planet/shkarkimet e deklaruara në këtë Formular-Kërkese për tu paisur me Leje Mjedisi Tipi B.
- Subjekti të jetë në dijeni dhe të azhornohet për kuadrin ligjor për mjedisin dhe ndryshimeve të tij.
- Subjekti të respektojë dhe zbatojë kushtet teknike në objekt për mbrojtjen nga zjarri dhe të krijojë infrastrukturën e nevojshme për zjarrëfikset.
- Të kryhet monitorimi i indikatoreve te mjedisit sipas ligjeve në fuqi.
- Si rezulat i realizimit të projektit nuk do të absorbohen ndikime të rëndësishme mjedisore, sociale në shëndetin e njerëzve. Për pasoje ndikimet e parashikuara mund të minimzohen duke zbatuar masat e përmëndura më sipër.
- Nga analiza për identifikimin e ndikimeve rezulton se ndikimi do të jetë i drejtpërdrejtë, i shkaktuar vetëm nga stacioni i transferimit te mbetjeve, larjes, magazinimit te mbetjeve.
- Është detyrë e zbatuesve të projektit të integrojnë elementët e domosdoshëm të propozuar për parandalimin, minimizimin dhe eleminimin e ndikimeve negative në mjedis, shëndet dhe aspektin social.
- Është detyrë e të gjith kontraktorëve e nënkontraktorëve të ndryshem të zbatojnë me kujdes detyrimet përkatëse të parashikuara më sipër.

Masa lehtësuese të tjera të kërkuara

- Do të bëhet një menaxhim sa më me eficent të energjisë elektrike, kjo do të coj në uljen e ndotjeve termike të mikroklimës së zonës si dhe kursim të energjisë elektrike nga përdorimi i makinerive/impianti me eficencë.
- Përcaktimi i vend-parkimit të automjeteve si dhe pajisja e vend parkimeve me sinjalistikën përkatëse.
- Subjekti të kryej aktivitetin vetëm brenda kordinatave të siperfaqes qe disponon dhe te respektoje me perpikmeri kushtet e menaxhimit te mbetjeve dhe ligjit per Menaxhimin e Integruar te Mbetjeve.
- Makinerite/pajisjet e instaluara në objekt, do të koluaudohet në mënyrë periodike nga teknikë të specializuar dhe çertifikuar për të tilla procese.
- Veglat/Pajisjet/Makinerite e punës që shërbejnë për procese të ndryshme do të zëvendësohen me të reja, sipas jetëgjatësisë së tyre dhe eficencës që kanë në kryerjen e operacioneve te pastrimit nga mbetjet e ndryshme, per pastrimin dhe larjen e kontenierеve dhe magazinimit te mbetjeve.
- Ambienti i zyrave dhe pajisjet/mjetet/makinerite në zonën e shfrytëzuar do të lyhet periodikisht me bojë higjenike dhe antikorrozive, me qëllim plotësimin e kushteve Higjeno-Sanitare.
- Do të bëhet pastrimi periodik i rrjetit të drenazhimit të ujrave te larjes/pastrimit dhe ujerave të shiut në siperfaqen ku ushtrohet aktiviteti.
- Rrjeti elektrike është togëzuar për të shmangur ndonjë shkarkesë elektrike, konform kushteve teknike,
- Janë ndërmarrë të gjitha masat e domosdoshme të mbrojtjes kundra zjarrit. Për të mbrojtur kundër zjarrit të mundshëm që mund të bjerë do të ruhen largësitë mbrojtëse ndaj zjarrit të objektit dhe sheshit te parkimit te automjeteve te pastrimit.
- Aktiviteti i disponon infrastrukturën e nevojshme, me distancat e përcaktuara për rrugë kalim të punonjësve, automjeteve, zjarrëfiksave, etj.

- **Kërkesa shëndetësore dhe mjedisore gjatë fazës ushtruese të veprimtarisë**

Për parandalimin e ndikimeve negative në shëndet e në mjedis që mund të lindin gjatë ushtrimit të aktivitetit nga subjekti NOVA Construction 2012 Sh.p.k ne fushen e “pastrim, larje dhe sprucim te kontenierеve te mbetjeve, Stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme dhe magazinim i

mbetjeve", do të ketë parasysh dhe të respektojë rigozorisht kërkesar e Rregullores Nr. 1, datë 15.03.2006 "Për parandalimin e ndikimeve negative në shëndet e në mjedis", ku investitori do të marrë masa kryesore sic janë:

- Subjekti do të zbatojë kërkesat e lejes mjedisore si dhe normat e standartet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit nga ndikiment negative të veprimtarisë,
- Subjekti do të sigurojë zbatimin e masave që parandalojnë ndotjen e mjedisit dhe shkarkimet mbi normën e lejuar për zhurmat, ajrin, për ujin dhe për tokën, si dhe respektimin e kërkesave dhe të kushteve të Lejes Mjedisore të Tipit B.
- Menaxhimin e integruar te mbetjeve ne perputhje me kushtet e kontratave te punimeve civile dhe parimet e mbrojtjes se mjedisit.
- Për tu mbrojtur nga zjarri i mundshëm që mund të bjerë në objekt do të vendosen shuars dhe hidrantë për fikjen e zjarrit në vende të dukshme ne ambinentin ku zhvillohet veprimtaria ne fushen e menaxhimit te mbetjeve.
- Për uljen e niveleve të zhurmave: Duke respektuar nivelin e lejuar të zhurmës, të përcaktuar në Udhëzimin e përbashkët të Ministrit të Mjedisit dhe Ministrit të Shëndetsisë nr. 8, dt 27.11.2007 "Për nivelet kufi të zhurmave në mjedise të caktuara".

- **Masa per sigurimin teknik dhe mbrojtja ne pune**

Aktiviteti qe zhvillon subjekti **"NOVA Construction 2012" Sh.p.k** praktikisht nuk perben rrezik per stafin (punonjesit) e tij, per arsye se investimet jane te koheve te fundit, me nje instalimi/paisje te reja e moderne, i gjithe procesi i punes eshte i automatizuar cka e rrit sigurine e instalimeve/makinerive.

Instalimet dhe Mjetet e pastrimit te mbetjeve (mbetje jo te rrezikshme) jane te certifikuara dhe nder me bashkekohoret ku pjesa me e madhe e proceseve jane te automatizuara duke shmangur keshtu nderhyrjen e punonjesve dhe te punuarit prane tyre, per vec te tjerash shoqeria ka disa rregulla strikte te cilat zbatohen me rigorozitet.

- **Detyrimet e punedhenesit:** Punedhenesi vete ose nepermjet drejtuesit teknik qe ka te punesuar, duhet t'ju beje te ditur punemarresve:

1. Procesin e operacioneve ne teresi dhe te punes ne secilin prej instalimeve ku punon.
2. Pajisjet dhe makinerite qe perdoren ne objekt per larjen, pastrimin e kontenierеve, makinerite e stacionit te transferimit te mbetjeve jo te rrezikshme, magazinimin e kontenierеve.
3. Shkaqet e aksidenteve dhe masat dhe per menjanimin e tyre.
4. Rregulloret e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune ne Republiken e Shqiperise, aktet ligjore dhe udhezimet ne zbatim te tyre, te leshuara nga dikasteret qe lidhen me to.
5. Rregullat e sigurimit teknik qe lidhen me frontin e punes, makinerite dhe profesionin qe kryen sipermarresi si individ per mbrojtjen e vetes dhe punonjesve te tjere.
6. Rregullat e pergjithshme te sigurimit teknik ne impiante dhe sheshin e punes, per tu mbrojtur nga makinerite, rrymes elektrike, shkarkesat atmosferike, etj.
7. Ndihmen e pare shendetesore.
8. Instruktimi paraprak dhe periodik i punonjesve, dokumentohet sipas formalitetit te percaktuar ne rregulloren e sigurimit teknik.
9. Ndalohet riparimi i avarive dhe punime te tjera kur makinerite jane ne levizje/procese pune.
10. Para se te fillohet nga puna behet kontrolli i frontit te punes, gjendja teknike e makinerive/pajisjeve etj.

Detyrimet e punemarresit: Detyrimet kryesore jane:

1. Te njoh rregulloren e sigurimit teknik dhe te mbrojtjes ne pune te leshuar nga Inspektorati i Sigurimit Teknik dhe Inspektorati i Punes dhe ti zbatoje ato ne pune.
2. Te dije mire shkaqet e mundshme te aksidenteve per çdo proces pune.
3. Te siguroje veten dhe punonjesit e tjere gjate procesit te punes ne zbatim.
4. Kur konstaton shenja te nje avarie te mundshme qe eshte burim aksidenti, ne radhe te pare te marre masa per eliminimin e saj, nderkohe lajmeron gjithe punonjesit per rrezikun dhe ve ne dijeni drejtuesin teknik/perfaqesuesin ligjor te shoqerise.
5. Te perdoren mjetet e mbrojtjes individuale ne pune si: kapele, doreza, maskat e mbrojtjes nga pluhuri, gazrat dhe tapa veshi per zhurmat, uniforme te vecanta etj.
6. Te kete njohuri te mjaftueshme per ndihmen e shpejte.

- **MONITORIMI I PLANIFIKUAR I SHKARKIMEVE NGA INSTALIMI.**

Qëllimet e monitorimit mjedisor

Monitorimi për parametrin që na intereson bëhet nëpërmjet matjeve të përsëritura, që merren me një frekuencë të mjaftueshme, për të bërë të mundur vlerësimin e gjendjes së mjedisit dhe ndryshimeve të tij në kohë.

Qëllimi i monitorimit mjedisor për stacionin e transferimit, magazinimit te kontenierеve, pastrim, larje te kontenierеve dhe magazinimin e perkohshem te mbetjeve është që të sigurojë të dhëna nëpërmjet të cilave të vlerësohet nëse zhvillimi i veprimtarisë është në përputhje me ligjet dhe standardet mjedisore që lidhen me të, për të vlerësuar shkallën e ndikimit (nëse ka), si dhe për të vlerësuar performancën mjedisore të menaxhimit të saj në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm.

Objektivat e Monitorimit:

- Të krahasojë cilësinë dhe gjendjen e mjedisit para fillimit të aktivitetit me atë gjatë funksionimit të istalimeve.
- Të monitorojë emetimet (nëse ka) në të gjitha fazat e zhvillimeve të projektit në përputhje me normat dhe standardet ligjore të Shqipërisë dhe BE.
- Të përcaktojë nëse ndryshimet e mundshme mjedisore janë si rezultat i zhvillimeve të aktiviteteve që kryhen në rajonin ku ndodhet objekti ku jane instaluar stacioni i transferimit, magazinimit te kontenierеve, pastrim, larje te kontenierеve dhe magazinimin e perkohshem te mbetjeve dhe nëse ka lidhje dhe impakte kumulative me aktivitetin e propozuar.
- Për të përcaktuar efektivitetin e masave përmirësuese të zbatuara nga aktorët zhvillues të aktivitetit në rajon.
- Për të përcaktuar impaktet afatgjatë (nëse ka).
- Për të përcaktuar zgjatjen e kthimit në normalitet të cilësisë së mjedisit në rajon, në rastet kur vlerësohet se ka ndikime dhe impakte në të.
- Të krijojë një arkivë (regjistër) të cilësisë së mjedisit, një bazë të dhënash që do të mund të përdoret në të ardhmen.
- Për të garantuar përshtatshmërinë e një objekti mjedisor për tu përdorur për qëllim të caktuar.

Plani i Monitorimeve Mjedisore

Monitorimi i burimeve natyrore, ajrit, ujit, tokës, shkarkimeve urbane, menaximit te mbetjeve, zhurmave etj, kryhet sipas disa kritereve shkencore përsa i përket vrojtimeve, mbledhjes dhe analizave të mostrave. Ai synon në mbledhjen e të dhënave për të vrojtuar dhe parashikuar rolin e faktorit njeri dhe natyror në ndryshimet e mjedisit, ku ai është aktiv.

Objektivat kryesore të monitorimit janë:

- Për të zbuluar ndryshimet dhe për të karakterizuar saktësisht nga ana sasiore tendencat (prirjet) e zhvillimit të burimeve.
- Për të siguruar informacione mbi lidhjen midis kushteve (gjendjeve) të burimeve dhe shkaqeve të tyre.
- Për të evidentuar cilësinë e mjediseve ku njeriu ushtron aktivitetin e tij jetësor, me synim për të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e tyre.
- Për të vlerësuar efektivitetin e politikave dhe veprimeve për menaxhimin e burimeve natyrore.

Monitorimi është detyre e investitorit për pikat Ç1, Ç2, Ç5, Ç6, Ç7, Ç8 të ligjit "Për monitorimit e mjedisit në Republiken e Shqipërise", kreu III, pika 10.

Plani i monitorimit mjedisor është i inkorporuar në projekt dhe përfshin inspektime dhe raportime rutinë. Më poshtë do të paraqesim disa monitorime që do të realizohen për treguesit e trysnisë në mjedis që janë detyrë e investitorit ku ai do të bashkëpunoj me instancat përkatëse.

Monitorimi i cilësisë së ujit:

Monitorimi gjatë operimit të aktivitetit, duhet bërë në zonat që ka vendosur supervizori. Monitorimi fillestar i cilësisë së ujit rekomandohet në zonat me burimet më të mëdha të ndotjes potenciale të ujit.

Rekomandohet matja e grimcave në suspencë (MES), kërkesa biologjike për oksigjen NBO5, konduktiviteti dhe coliformet fekale. Frekuenca e monitorimeve do të përcaktohet nga specialistët e lejeve të mjedisit dhe do të kontrollohen inspektorët e mjedisit (supervizori) gjatë operimit te punes.

Monitorimi i cilësise së ajrit:

Monitorimi i cilësisë së ajrit duhet bërë në zonat që ka vendosur supervizori, brenda zonës që do të ushtrohet ndikimi.

Monitorimi me aparate për ndotësit e ajërit, përvec grimcave te ngrurta PM10 dhe PM2.5 nuk konsiderohet e justifikueshme në kushtet ekzistuese të ambjentit, sepse nuk ka impakte të rëndësishme në këtë projekt.

Masat e sigurisë për monitorim shtesë me kërkesë të supervizorit do të specifikohen nëse hasen rrethane të paparashikuara.

Monitorimi i zhurmave:

Operimi i pajisjeve dhe i makinerive gjatë gjithë procesit, kërkon të monitorohet niveli i zhurmave, i cili nuk duhet të kalojë nivelet e caktuara. Ndotja akustike në mjediset e punës është parësore për shoqërinë, sepse sjell uljen e produktivitet të punonjësve dhe rritje të stresit.

Investitori do të realizoj monitorim me aparatura, një herë përpara fillimit të punimeve, për të vendosur drejtimet kryesore të impakteve që do të maten. Monitorimi fillestar i zhurmave do të kërkohet vetëm aty ku kohëzgjatja e potëncialeve të ndikimeve dhe receptorëve e ndjeshëm të justifikoj këtë monitorim.

Monitorimi i mbetjeve

Monitorimit gjatë funksionimit, lidhur me stacionin e transferimit, magazinimit te kontenierеve, pastrim, larje te kontenierеve dhe magazinimin e perkohshem te mbetjeve dhe menaxhimin e mbetjeve të gjeneruara dhe ne respektim me ligjin per menaxhimin e integruar te mbetjeve.

Programi i monitorimit do të përdoret për të verifikuar që të gjitha ndotjet e mundshme që do t'i shkaktohen mjedisit nga funksionimi në këtë aktivitet. Investitori do të monitorojë vetëm pikat për të cilat ai ndikon mbi to (pikat do të përcaktohen nga organet kompetente), si dhe i dërgojnë këto të dhëna në Agjencinë Kombetare të Mjedisit të paktën dy herë në vite, sipas legjislacionit perkates. Këto të dhëna do të vihen në dispozocion të inspektorëve të mjedisit gjatë inspektimit të tyre.

Realizimi i objektivave dhe treguesve të pritshëm të parashikuar në projekt do të varet nga respektimi i të gjithë treguesve të përcaktuar. Kontrolli, monitorimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm, sipas kushteve të shfrytëzimit të krijuar gjatë aktivitetit, do të çojë përfundimisht në përfitimin e pamjeve të parashikuar në projekt me sipërfaqe të sistemuar dhe të gjelbëruar, si dhe me një ambient shërbimi të mire menaxhuar duke menduar për brezat pasardhës.

f. KONSULTIMET NDERKUFITARE

Zona ku zhvillohet do te zhvillohet aktiviteti nuk ka nevoje ti nenshtrohet procesit te konsultimit nderkufitar.

g. AUTORITETI VENDIMARRES PER DHENIEN E AKTIT TE MIRATIMIT TE LEJES SE MJEDISIT, PROCEDURAT DHE AFATET QE NDIQEN.

Autoriteti miratues eshte Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministri i Turizmit dhe Mjedisit firmos per miratimin apo refuzimin e aplikimit per tu pajisur me leje mjedisit te tipi B, me propozim nga Agjencia Kombetare e Mjedisit, e cila shqyrton dokumentacion e paraqitur nepermjet Qendres Kombetare te Biznesit.

Afati per marrjen ne shqyrtim te aplikimit per pajisjen me leje mjedisit te tipit B eshte 40 dite pune.

h. ADRESA E AKM-SE, KU PUBLIKU MUND TE DERGOJE KOMENTET DHE SUGJERIMET E TIJ, ME SHKRIM APO NE FORME ELEKTRONIKE, BRENDA 20 DITE NGA DATA E NJOFTIMIT.

Faqja zyrtare e Agjencise Kombetare te Mjedisit: akm.gov.al